



VENDIM MBI PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 30 gusht 2013

Numri i lëndës: 2013-16

Almir Susaj

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 30 gusht 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Së pari ankuesi ju është drejtuar Panelit me një letër më 15 prill 2013. Pasi që ka ofruar informata shtesë, ankesa ishte regjistruar në Panel më 24 qershor 2013.

II. FAKTET

2. Ankuesi është shtetas shqiptar, i cili është dënuar në Kosovë me burgim të gjatë. Ai pretendon se ju është nënshtruar torturës, keqtrajtimit dhe diskriminimit në burg, për shkak se ai i takon besimit të krishterë dhe se ka nënshtetësi shqiptare.
3. Ankuesi pohon se është keqtrajtuar në qendrën korrektuese në Dubravë gjatë një bastisje nga i ashtuquajtimi Ekipi për Ndërhyrje më 21 mars 2013. Për më tej, ai pohon se është fyer dhe është vendosur në izolim pa ndonjë arsyetim. Kur kishte kërkuar ndihmë mjekësore, supozohet se ishte spërkatur me gaz lotsjellës dhe ishte rrahur derisa kishte humbur vetëdijen.
4. Ankuesi i paraqet dëshmitë e lëndimeve, përfshirë fotografitë që janë në dosjen e reparit mjekësor si dhe në departamentin e sigurisë së qendrës korrektuese.
5. Ankuesi gjithashtu pohon se ishte kufizuar që të kontaktonte familjen e tij dhe ishte penguar që të ketë qasje në disa objekte, p.sh. në librarinë dhe palestrën e burgut. Ankuesi ka parashtruar ankesë tek autoritetet e burgut. Më 29 mars 2013 ai ishte transferuar në qendrën e burgut në Gjilan.

III. ANKESAT

6. Ankuesi supozon se ishte torturuar, keqtrajtuar dhe diskriminuar nga autoritetet e burgut për shkak të religjionit dhe nënshtetësisë së tij.

IV. LIGJI

7. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit, në thelb, ka të bëjë me trajtimin e tij nga autoritetet e burgut. Paneli vëren se nuk është argumentuar e lere më treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në çfarëdo mënyre në shkeljet e supozuara.
10. Rrjedh se çështjet e ngritura nga ankuesi nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Si pasojë ato janë jashtë

mandatit të Panelit siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

11. Paneli konstaton më në fund se ankuesi mund të ngrit çfarëdo çështje lidhur me pretendimet për keqtrajtim tek autoritetet kompetente të prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se ankesa është e pabazuar sipas nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese